



Republika e Kosovës
KOMUNA E MALISHEVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË SKUPŠTINA OPŠTINE-MALISHEVO



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 12.04.2010
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 06/54

**RREGULLORE
MBI MBROJTJEN
NGA ZJARRI NË TERRITORIN
E KOMUNËS SË MALISHEVËS**

Malishevë-Mars, 2010

Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-41 mbi Mbrojtjen nga Zjarri, Ligjit Nr. 02/L-68, mbi Fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë të tjera, dhe Statutit të Komunës Neni. 10. paragafi 10.1. shkronja "g", Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledjen e mbajtjur me datë 26.03.2010, m i r a t o i këtë:

R R E G U L L O R E

Mbi mbrojtjen nga Zjarri në territorin e Komunës së Malishevës

Neni 1

Me këtë Rregullore caktohen kushtet dhe masat për pengimin dhe evitimin e rrezikut nga zjarri dhe shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë së rrezikuar nga zjarri.

Neni 2

Administrata lokale dhe organet e saj, ndërrmarrjet, Njësitë zjarrëfikëse dhe qytetqrët për ta mbrojtur jetën e njerëzve dhe pasurinë nga zjarri, marrin masa për evitimin e rrezikut nga zjarri, për shuarjen dhe dhënien e ndihmës për evitimin e pasojave të shaktuara nga zjarri.

Neni 3

Mbrojtja nga zjarri përfshin një tërësi masash dhe veprimesh që ndërrmirren për pengimin, zbulimin dhe shuarjen e zjarrit, si dhe shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë të rrezikuar nga zjarri.

Neni 4

Organet e Administratës, ndërrmarjet, institucionet tjera dhe qytetarët kanë për detyrë që me zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri të veprojnë në pajtim me këtë Rregullore, të hartojnë planet e mbrojtjes nga zjarri, si dhe aktet tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga zjarri.

Neni 5

Përpos masave të mbrojtjes nga zjarri të parapara me këtë Rregullore, Asambleja e Komunës, duke marrë parasysh rrethanat dhe nevojat e qytetarëve, mund të parasheh edhe ndonjë masë tjetër plotësuese, me qëllim të parandalimit, shpërthimit të përhapjes dhe fikjes së zjarrit.

Neni 6

Asambleja Komunale bjen vendim për nxjerrjen e Planit dhe Rregullores mbi mbrojtjen nga zjarri, për territorin e Komunës, dhe kujdeset për realizimin e tij nëpërmjet të Drejtorisë për mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 7

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim organizon mbrojtjen nga zjarri në tërë territorin e Komunës, dhe zbaton masa të caktuara të mbrojtjes nga zjarri.

Neni 8

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, me vendimin e Asamblesë, dhe me obligimet që ka caktuar Ndërrmarrja dhe institucionet tjera që janë të obliguara t'i nxjerrin Rregulloret për mbrojtjen nga zjarri formojnë Njësitë zjarrëfikëse sipas nevojës.

Neni 9

Rregulloret e mbrojtjes nga zjarri i nxjerrin të gjitha ndërrmarrjet apo subjektet tjera nga alineja 1 e këtij neni, të cilat duhet të jenë të harmonizuara me Rregulloren apo planet e Drejtorisë për M dhe SH të KK të Malishevës, për mbrojtjen nga zjarri, mënyrën e përdorimit të Njësive zjarrëfikëse, sistemin e informimit, procedurën në raste shpërthimi të zjarrit, pajisjen teknike, si dhe mjetet tjera për shuarjen e zjarrit.

Neni 10

Vend me rëndësi për mbrojtjen nga zjarri duhet të zërë mënyra e furnizimit me ujë, rrugët, vend-kalimet, bashkëveprimi me Njësitë tjera zjarrëfikëse, si dhe masat tjera që janë të nevojshme për funksionimin e suksesshëm dhe përparimin e mbrojtjes nga zjarri dhe zbatimin e mbikqyrjes lidhur me kryerjen e masave të mbrojtjes nga zjarri.

Neni 11

Përpos masave nga alineja 2 e këtij neni, Rregullorja paraqet edhe masa të veçanta për mbrojtjen e pajisjeve nga zjarri dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Neni 12

Me Planin Urbanistik dhe Hapsinor duhet të parashihen edhe masa tjera mbrojtëse siç janë:

- 12.1 Burimet e furnizimit me ujë, kapaciteti i ujësjellësit të qytetit që duhet të sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit për shuarjen e zjarrit.
- 12.2 Largësinë mes zonave të parapara për objektet e banimit, objektet industriale si dhe objektet për destinim special (depotë e langjëve që ndezen lehtë, gazrave dhe materieve eksplozuese).
- 12.3 Largësinë mes objekteve për destinime të ndryshme. Brenda Zones industriale dhe objekteve speciale që bënë të mundur zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri.
- 12.4 Gjerësinë e rrugëve që bëjnë të mundur afrimin e automjeteve për zjarrëfikje, deri te çdo objekt, dhe manovrimin e tyre gjatë shuarjes së zjarrit.

Neni 13

- 13.1 Organizatat projektuese në territorin e komunës së Malishevës, kanë për detyrë që me rastin e përcaktimit të objekteve ndërtimore, instalimeve, adoptimeve dhe konstruktiveve të aplikohen masat për mbrojtje nga zjarri dhe me dispozitat e nxjerra në bazë të kësaj Rregulloreje.

- 13.2 Projektuesit duhet ti aplikojnë masat për mbrojtje nga zjarri të caktuara sipas kësaj Rregulloreje me rastin e projektimit hapsinor dhe urbanistik

Neni 14

Me rastin e projektimit dhe të ndërtimit të godinave, banesave dhe të objekteve për përdorim publik, si shtëpitë e mallarave, hotelet, kinematë, teatrot, bibliotekat, shkollat, spitalet, hallat sportive, si dhe objektet tjera për përdorim publik, domosdo të sigurohen kushtet për evakuim të sigurt të njerëzve në rast të zjarrit, si dhe aparateve për fikjen e zjarrit.

Neni 15

Objektet në të cilat prodhohen, përpunohen dhe mbahen lëndet djegëse, gassjellësit dhe të gjitha instalimet me aprate në këto objekte, para dhënjes së lejes duhet marrë pëlqimin nga organi kompetent i preventivës së mbrojtjes kundër zjarrit, në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 16

Objektet ndërtimore në të cilat prodhohen, përpunohen dhe mbahen materialet ndezëse, eksplozivi dhe materie të ngjajshme, mund të ndërtohen vetëm në ato vend, e dhe në atë mënyrë që nuk i kanoset rreziku nga zjarri dhe eksplodimi për objektet tjera, e kur të vërtetohet se në to janë zbatuar masat mbrojtëse nga zjarri të parapara me dokumentacion investivo-teknik.

Neni 17

Në objektet dhe lokalet në të cilat prodhohet, përpunohet, shfrytëzohen dhe mbahen lëndët ndezëse, gazrat, eksplozivi dhe materie tjera që ndezen lehtë ose ku krijohet përzierja eksplozive, nuk lejohet:

- 17.1 Pirja e duhanit, përdorimi i zjarrit të hapur dhe mjetet për ndezje.
- 17.2 Shfrytëzimi i stabilimenteve dhe instalimeve që mund të shkaktojnë shpërthimin e zjarrit dhe eksplodimit ndalon:
- 17.3 Të përdoren vegla që nxjerrin xixa.
- 17.4 Shfrytëzimi i aparateve të ngrohjes me zjarr të hapur me sipërfaqe të caktuar.

17.5 Mbrojtja dhe vendosja e materialit që mund të ndezet vetë.

Neni 18

Në objektet prodhuese publike, të banimit dhe në objekte tjera, instalime teknike, të ventilimit, të gazrave, të naftës-jellësve, të rrufepritësve, të kanalizimit dhe instalimet tjera, duhet të bëhen në atë mënyrë që të mos praqesin rrezik nga zjarri.

Neni 19

Në ndërtesat e banimit, si dhe ndërtesat në të cilat vendosen ose tubohen numër i madh personash, sigurohen aparatet përkatëse, pajisja me mjete për fikjen e zjarrit dhe ndërmirren masa tjera preventive.

Neni 20

Në ndërtesat e banimit dhe lokale afariste si dhe në objekte tjera, ndërtimore me stabilimentet, instalimet elektrike, të gazrave dhe instalimeve tjera, si dhe rrymëpërcjellësit, duhet të mbahen në gjendje të rregullt ku bartës i përgjigjesisë është pronari i ndërtesës familjare të banimit ose lokalit.

Neni 21

- 21.1 Në objektet në të cilat tubohen numër i madh personash, respektivisht mbahen tubimet publike, organizuesit kanë për detyrë që deri sa këto të zgjasin, të sigurojnë zjarrëfikësit kujdestarë.
- 21.2 Organet e administrates, ndërmarrjet dhe institucionet tjera, dyqanet zejtare, hoteliere dhe tregtare kanë për detyrë të kenë aparate përkatëse për shuarjen e zjarrit fillestar.

Neni 22

Organet e Administrates, ndërmarrjet dhe insitucionet tjera kanë për detyrë t'i njoftojnë punëtorët e inkuadruar për rrezikun nga zjarri, për mënyrën e zbatimit të masave mbrojtëse, si dhe me përdorimin e aparateve të paisjeve dhe të mjeteve për shuarjen e zjarrit.

Neni 23

- 23.1 Me rastin e ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit me hidrante të zjarrit duhet të sigurohen kapaciteti rrjedhës dhe me shtypje për shuarjen e zjarrit.
- 23.2 Në mungesë të hidrantëve dhe mungesë të mjaftueshme të ujit në ujësjellës për shuarjen e zjarrit shfrytëzohen pusat, pishinat, rezervat, si dhe mënyra të tjera vetëm e vetëm për ta shuar zjarrin.

Neni 24

- 24.1 Aparatet, pajisjet teknike dhe mjetet e destinuara për shuarjen e zjarrit, mund të blehen nëse u përgjigjen standardeve.
- 24.2 Aparatet, pajisjet teknike dhe mjetet për shuarjen e zjarrit, të cilat nuk janë paraparë me standardet, apo janë importuar, mund të shfrytëzohen vetëm sipas atestit të siguruar nga institucionet profesionale të autorizuar.

Neni 25

- 25.1 Organet e Administratës, ndërmarrjet dhe institucionet tjera me aktin e vetë normative përcaktojnë masat dhe punët lidhur me zbatimin dhe përparimin e mbrojtjes nga zjarri, në pajtim me këtë Rregullore dhe dispozita tjera:
- 25.2 Masat për mbrojtje nga zjarri
- 25.3 Organizimin, fushëveprimin dhe autorizimet e shërbimit të zjarrëfikjes.
- 25.4 Përgatitjen e punëtorëve që ushtrojnë punët nga zjarri.
- 25.5 Organizimi dhe mënyra e kontrolit të autorizuar dhe përgjegjësve.
- 25.6 Pajisjen teknike përkatëse dhe mjetet për shuarjen e zjarrit.
- 25.7 Detyrat dhe përgjegjësitë e udhëheqësve dhe punëtorëve për masat mbrojtëse nga zjarri.
- 25.8 Përgjegjësinë materiale dhe përgjegjësit tjera për mos kryerje obligimi.
- 25.9 Detyrat e anëtarëve dhe organeve drejtuese me rastin e shpërthimit të zjarrit dhe pjesëmarrja e tyre në shuarjen e zjarrit.

Neni 26

Për zbatimin e masave të parapara me këtë Rregullore për mbrojtje nga zjarri përgjegjës është pronari i ndërtesës respektivisht në ndërmarrje shoqërore-Eprori i ndërmarrjes.

Neni 27

Me punët e caktuara lidhur me përparimin e mbrojtjes nga zjarri mun të merren ndërmarrjet dhe institucionet tjera që i plotësojnë kushtet në pikëpamje të përgatitjes teknike dhe që disponojnë me kuadro profesionale për kryerjen e punëve me shuarjen e zjarrit.

Neni 28

- 28.1 Gjatë kohës së korrijës dhe shirjes ndërmirën masa të posaçme që të lashtat të mbrohen nga zjarri.
- 28.2 Organet Komunale, Administrata lokale, ndërmarrjet dhe organizatat bujqësore formojnë shtabet e përbashkëta në zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri.
- 28.3 Këto shtabe kanë detyrë kontrollin teknik të makinave fshirëse, traktorëve, kombajnave e mjeteve tjera që mos të vijë deri te paraqitja e zjarrit, e në rastet paraqitjes, të bëhet informimi i menjëhershëm për të evituar rrezikun e shkatërrimit të drithnajave me përmasa më të gjëra.

Neni 29

Me qëllim të marrjes pjesë në zbatimin e masave preventive të mbrojtjes nga zjarri, si dhe për shuarjen e zjarrit me shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë së rrezikuar nga zjarri, formohen Njësitë zjarrëfikse nëpër ndërmarrje dhe organizata tjera.

Neni 30

Me aktin mbi formimin e Njësisë zjarrëfikse, përcaktohet fushëveprimi i punës së Njësisë, pajisja teknike si dhe forma e financimit.

Neni 31

Ndërmarrjet që prodhojnë, përpunojnë dhe mbajnë material ndezës, eksploziv, gazra dhe materiale tjera ndezëse, kanë për detyrë që të kenë të formuar Njësinë zjarrëfikse të përhershme dhe të aftësuar.

Neni 32

Njësitë zjarrëfikse kanë për detyrë që reciprokisht të bashkëpunojnë dhe t'i japin ndihmë njëra-tjetrës.

Neni 33

Ndërmarrjet janë të obliguara që të sigurojnë për Njësit e tyre zjarrëfikse uniforma përkatëse, me pajisje të nevojshme dhe profesionale të atestuara.

Neni 34

Qytetarët mund të themelojnë Shoqërinë zjarrëfikse vullnetare në vendet ku jetojnë, të jenë të aftësuar profesionalisht, të jenë të regjistruar në Administratën ndërkombëtare dhe lokale.

Neni 35

- 35.1 Çdo qytetar që vëren shpërthimin e zjarrit ka për detyrë dhe obligim që ta shuajë nëse këtë mund ta bëjë, pa iu kanosur rreziku atij apo të tjerëve.
- 35.2 Nëse nuk është në gjendje ta shuajë zjarrin ka për obligim që të informojë Njësinë zjarrëfikse, policinë apo ndonjë organ tjetër më të afërm.
- 35.3 Punëtoret në mbrojtjen e pyjeve dhe ndërmarrja e cila udhëheq me pyje, përpos obligimit të tyre organizon fikjen e zjarrit me pjesëmarrje të qytetarëve e lokalitetit më të afërt të zjarrit.

Neni 36

- 36.1 Nëse Njësia zjarrëfikse nuk mund të fikë zjarrin, eprori i njësisë do të kërkojë ndihmë nga njësitë tjera zjarrëfikse nga territori i Komunës.
- 36.2 Njësia zjarrëfikse nga e cila është kërkuar ndihma, ka për detyrë të japë ndihmë në pajtimin me këtë Rregullore për mbrojtje nga zjarri.
- 36.3 Nëse edhe me pjesëmarrjen e Njesisë nuk është arritur shuarja e zjarrit, ftohen Njësitë profesionale të zjarrëfiksëve, apo në qoftë se zjarri ka marrë përmasa më të mëdha kërkohet ndihma nga Komunitet tjera të Kosovës.

Neni 37

Për shuarjen e zjarrit ka pengesë dhe në mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë së rrezikuar nga zjarri, udhëheqësi i aksionit të shuarjes së zjarrit ka të drejtë dhe detyrë:

- 37.1 Të ndalojë afrimin e personave të pa ftuar në vendin e shuarjes së zjarrit, si dhe qarkullimin e komunikacionit afër atij vendi.
- 37.2 Të udhërojë evakuimin e personave dhe pasurisë nga lokalet dhe objektet e rrezikuara.
- 37.3 Të urdhëroi ndërprerjen e energjisë elektrike, të gazit dhe lëndëve djegëse.
- 37.4 Të urdhërojë përdorimin e ujit që shfrytëzojnë qytetarët, Administrata Komunale, ndërmarrjet si dhe institucionet, nëse nuk sigurohet ndonjë burim tjetër për shuarjen e zjarrit.
- 37.5 Të urdhëroi shfrytëzimin e automjeteve të qytetarëve, organeve shtetërore, ndërmarrjeve me qëllim të transportit të të lënduarëve nga zjarri, si dhe sjelljen e mjeteve për shuarjen e zjarrit.
- 37.6 Të urdhërojë rrënimin e pjesërishëm ose të plotë të objektit që nuk është përfshirë nga zjarri, në raste se nuk mund të sigurohet në mënyrë tjetër shuarja e zjarrit ose shpëtimi i njerëzve.
- 37.7 Të marrë masa për sigurimin e pasurisë së evakuar.
- 37.8 Të hapë me force objektin ose lokalitetin e mbyllur me qëllim të shuarjes së zjarrit ose shpëtimit të njerëzve dhe pasurisë.

Neni 38

- 38.1 Në rast të shpërthimit të zjarrit në përmasa më të gjëra, Kryetari i Komunës dhe Komiteti për Gatishmeri Emergjente ose personi i autorizuar nga këta, mund të japë urdhër që të gjithë personat nga territori i Komunës të cilët janë mbi moshën 16 vjeçare të marrin pjesë në shuarjen e zjarrit.
- 38.2 Kryetari i Komunës dhe KGE ose personi i autorizuar nga këta, mund t'i urdhërojë qytetarët, Administratën, ndërmarrjet, njësitë zjarrëfikse si dhe institucionet tjera që merren të nevojshme për shuarjen e zjarrit.
- 38.3 Me aksionin e shuarjes së zjarrit udhëheqësi i Njesisë, e cila e para ka arritur në vendin e ngjarjes, nëse ndryshe nuk merren vesh.

Neni 39

Njësitë zjarrëfikse kanë për detyrë t'ju vijnë në ndihmë edhe Njësitë zjarrëfikse të FSK-së si dhe njësitë tjera të Oraganizatave punuese dhe subjekteve tjera, ndërsa në shuarjen e zjarrit udhëheq eprori i asaj njësie që ka arritur i pari në vendin e ngjarjes, nëse ndryshe nuk merren vesh.

Neni 40

Nëse për shuarjen e zjarrit, shpëtimin e njerëzve dhe të pasurisë së rrezikuar nga zjarri, është e nevojshme ndihma e Njesisë zjarrëfikse të shtetit fqinjë, atë ndihmë e kërkon Kryetari i Komunës dhe Komiteti për Gatishmeri Emergjentë ose personi i autorizuar nga këta

Neni 41

Mbikqyrjen në zbatimin e dispozitave dhe masave për mbrojtjen nga zjarri e bënë Organi i Preventivës dhe Inspektimit në bashkpunim me PK-së.

Neni 42

Organet e Administrates, ndërmarrjet dhe institucionet tjera, si dhe qytetarët kanë për detyrë t'ju mundësojnë Inspektorëve në kryerjen e punës pa pengesa në lëminë e mbrojtjes nga zjarri dhe të japin shënime në lidhje me paraqitjen e zjarrit.

Neni 43

Nëse organet e administrates, ndërmarrjet dhe institucionet tjera dhe qytetarët nuk i kanë zbatuar masat mbrojtëse nga zjarri, organi kompetent i preventives së mbrojtjes nga zjarri, jep urdhër për kryerjen e këtyre masave dhe cakton afatin për kryerjen e tyre.

Neni 44

Organi kompetent i preventives së mbrojtjes nga zjarri përveç masave të caktuara të mbrojtjes nga zjarri, me vendim mund të caktoj ndërmarrjen edhe të këtyre masave:

- 44.1 Zgjerimin, meremetimin dhe adoptimin e objekteve me qëllim të pengimit, shpërthimit dhe përhapjes së zjarrit.

- 44.2 Meremetimin, transformimin ose demontizimin e aparateve dhe instalimeve nga të cilat kanoset rreziku i shpërthimit të zjarrit.
- 44.3 Largimin e pengesave ndërtimore dhe pengesave tjera ose instalimeve që me rastin e shpërthimit të zjarrit pengojnë në shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë.
- 44.4 Ndalimin e përdorimit të objekteve, mjeteve, aparateve të punës, instalimeve dhe gjërave të tjera që konstatohet se me përdorimin e tyre paraqet rrezik për përhapjen e zjarrit.
- 44.5 Ndalimin e përdorimit të aparateve për nxemje me zjarrë të hapët, të sipërfaqeve tepër të nxehta dhe të skuqura me flakë të aparateve për salldim.
- 44.6 Ndalimin e pirjes së dukanit në objekte, lokale dhe hapsirë, në të cilat vendosen ose shfrytëzohen langjet ndezëse, gazrat ndezëse, materialet eksplozive ose krijohen përzierje eksplozive dhe materiale tjera ndezëse.
- 44.7 Blerjen e aparateve të nevojshme zjarrëfikse, pajisjeve me mejte për shuarjen e zjarrit si dhe ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.
- 44.8 Njohjen e punëtorëve me burimin e rreziqeve nga zjarri, me masat mbrojtëse nga zjarri dhe me mënyrën e përdorimit të aparateve dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit.

Neni 45

Për respektimin e kësaj Rregullore në kryerjen dhe mos kryerjen e detyrave, Organi i Preventivës dhe Inspektimit i DMSH, ka për detyrë të përpilojë procesverbalin dhe një kopje të procesverbalit i dorëzohet organit të administrates, ndërmarrjes ose institucioneve tjera në të cilat është kryer kontrolli.

Neni 46

Mjetet për punë dhe pajisjet teknike të Njesisë zjarrëfikse në organet e Administrates, ndërmarrjet dhe institucionet i sigurojnë organet respektivisht organizatat të cilat kanë themeluar Njësinë zjarrëfikse.

Neni 47

Shoqëritë e sigurimit kanë për detyrë që t'i paguajnë fondit të mbrojtjes kundër zjarrit 5% nga të gjitha premitë e sigurimit nga zjarri.

Neni 48

Shuma e inkasuar nga gjobat për kundërvajtje nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri, i takojnë fondit të mbrojtjes kundër zjarrit në territorin e së cilës bëhet kundërvajtja.

Neni 49

Mjetet nga nenet 47 dhe 48 të kësaj Rregulloreje hyjnë në fondin e posaçëm për mbrojtjen nga zjarri dhe shfrytëzohen ekskluzivisht për përparimin e mbrojtjes nga zjarri siç janë:

- 49.1 Për blerjen e pajisjeve dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit.
- 49.2 Për ndërtimin e objekteve për vendosjen e Njësive zjarrëfikse dhe të pajisjeve.
- 49.3 Për shkollimin dhe përfeksionimin profesional të kuadrove të Njesisë zjarrëfikëse.
- 49.4 Për zhvillimin e aktiviteteve edukativo-preventive.

Dispozitat ndëshkimore

Neni 50

Me gjobë prej 1000 € deri 1500 €, do të dënohet për kundërvajtje ndërmarrja dhe përsone juridik

- 50.1 Nëse nuk ka nxjerrë Planin dhe aktet normative përkatëse mbi mbrojtjen nga zjarri
- 50.2 Nëse keqpërdorë mjetet për shuarjen e zjarrit.
- 50.3 Nëse nuk themelon Njësinë zjarrëfikse.
- 50.4 Nëse nuk zbaton masat e parapara ose të urdhëruara për mbrojtje nga zjarri.
- 50.5 Nëse nuk vepron sipas masave të parapara të mbrojtjes ndaj zjarrit në bujqësi dhe pylltari.
- 50.6 Nëse nuk i zbaton masat e urdhëruara të mbrojtjes nga zjarri në afatin e caktuar me aktvendimin e inspektorit të preventivës.

Neni 51

Me gjobë prej 500 € deri 1000 €, do të dënohet për kundërvajtje ndërmarrja dhe përsone juridik:

- 51.1 Nëse shfrytëzon respektivisht vë në veprim objektin, instalimin dhe lokalin e ndërtuar të adoptuar, dhe të konstruktuar para se të sigurojë lejen e organit kompetent sipas nenit 14.
- 51.2 Nëse nuk vepron sipas dispozitave të nenit 18 të kësaj Rregulloreje.
- 51.3 Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 20, 28 dhe 41 të kësaj Rregulloreje.
- 51.4 Në qoftë se është urdhëruar, për shkak të arsyeshëm nuk lë në dispozicion veglat, mjetet transportuese, teknike dhe mjetet tjera të nevojshme për shuarjen e zjarrit, dhe shpëtimin e njerëzve dhe të pasurisë së rrezikuar nga zjarri (neni 38).
- 51.5 Nëse parandalon dhe pengon Inspektorin në kryerjen e punëve të inspektimit ose refuzon t'ia japë shënimet dhe informatat e nevojshme "neni 45" për kundërvajtje nga alineja 1 e këtij neni denohet me gjobë deri me 150 Euro edhe përsone përgjegjës në ndërmarrje, respektivisht përsone tjetër juridik.

Neni 52

Me gjobë prej 500 € deri 1000 €, do të dënohen për kundërvajtje ndërmarrja dhe personi tjetër juridik:

- 52.1 Nëse nuk vepron sipas dispozitave të alinesë 1 të nenit 15.
- 52.2 Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 16.
- 52.3 Nëse nuk i merr masat preventive të mbrojtjes nga zjarri dhe nuk e siguron materialin dhe mjetet e nevojshme për shuarjen e zjarrit "neni 20".
- 52.4 Nëse nuk vepron sipas dispozitës së nenit 21 të kësaj Rregulloreje Për kundërvajtje nga alineja 1 të këtij neni do të dënohet me gjobë prej 50 € deri 100 € dhe personi përgjegjës në ndërmarrje, respektivisht personi juridik.

Neni 53

Me gjobë prej 50 € deri 100 €, dënohet personi-individi:

- 53.1 Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 35.
- 53.2 Nëse është urdhëruar në shuarjen e zjarrit, refuzon të marrë pjesë për shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë së rrezikuar "neni 37".
- 53.3 Me gjithë se është i urdhëruar nga organi kompetent, për shkak të arsyeshmë refuzon t'i lërë në dispozicion Njësisë zjarrëfikse, veglat, mjetet transportuese dhe mjetet tjera të nevojshme për shuarjen e zjarrit "neni 38".

Neni 54

Me gjobë prej 10 € deri 25 €, do të dënohet personi në vend të për kundërvajtje:

- 54.1 Nëse me kërkesën e personit të autorizuar nuk largohet prej vendit të zjarrit.
- 54.2 Nëse pi duhan ose përdorë zjarrin e hapur në vendin ku ajo është e ndaluar.
- 54.3 Nëse nuk mënjanon materialet ndezëse në lokalet dhe hapsirat e rrezikuara nga zjarri.



Republika e Kosovës
KOMUNA E MALISHEVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË SKUPŠTINA OPŠTINE-MALISHEVO



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 12.04.2010
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 06/54

RREGULLORE
MBI MBROJTJEN
NGA ZJARRI NË TERRITORIN
E KOMUNËS SË MALISHEVËS

Malishevë-Mars, 2010

Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-41 mbi Mbrojtjen nga Zjarri, Ligjit Nr. 02/L-68, mbi Fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë të tjera, dhe Statutit të Komunës Neni. 10. paragafi 10.1. shkronja "g", Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledjen e mbajtur me datë 26.03.2010, m i r a t o i këtë:

R R E G U L L O R E

Mbi mbrojtjen nga Zjarri në territorin e Komunës së Malishevës

Neni 1

Me këtë Rregullore caktohen kushtet dhe masat për pengimin dhe evitimin e rrezikut nga zjarri dhe shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë së rrezikuar nga zjarri.

Neni 2

Administrata lokale dhe organet e saj, ndërmarrjet, Njësitë zjarrëfikëse dhe qytetqrët për ta mbrojtur jetën e njerëzve dhe pasurinë nga zjarri, marrin masa për evitimin e rrezikut nga zjarri, për shuarjen dhe dhënien e ndihmës për evitimin e pasojave të shaktuara nga zjarri.

Neni 3

Mbrojtja nga zjarri përfshin një tërësi masash dhe veprimesh që ndërmirren për pengimin, zbulimin dhe shuarjen e zjarrit, si dhe shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë të rrezikuar nga zjarri.

Neni 4

Organet e Administratës, ndërmarrjet, institucionet tjera dhe qytetarët kanë për detyrë që me zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri të veprojnë në pajtim me këtë Rregullore, të hartojnë planet e mbrojtjes nga zjarri, si dhe aktet tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga zjarri.

Neni 5

Përpos masave të mbrojtjes nga zjarri të parapara me këtë Rregullore, Asambleja e Komunës, duke marrë parasysh rrethanat dhe nevojat e qytetarëve, mund të parasheh edhe ndonjë masë tjetër plotësuese, me qëllim të parandalimit, shpërthimit të përhapjes dhe fikjes së zjarrit.

Neni 6

Asambleja Komunale bjen vendim për nxjerrjen e Planit dhe Rregullores mbi mbrojtjen nga zjarri, për territorin e Komunës, dhe kujdeset për realizimin e tij nëpërmjet të Drejtorisë për mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 7

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim organizon mbrojtjen nga zjarri në tërë territorin e Komunës, dhe zbaton masa të caktuara të mbrojtjes nga zjarri.

Neni 8

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, me vendimin e Asamblesë, dhe me obligimet që ka caktuar Ndërmarrja dhe institucionet tjera që janë të obliguara t'i nxjerrin Rregulloret për mbrojtjen nga zjarri formojnë Njësitë zjarrëfikëse sipas nevojës.

Neni 9

Rregulloret e mbrojtjes nga zjarri i nxjerrin të gjitha ndërmarrjet apo subjektet tjera nga alineja 1 e këtij neni, të cilat duhet të jenë të harmonizuara me Rregulloren apo planet e Drejtorisë për M dhe SH të KK të Malishevës, për mbrojtjen nga zjarri, mënyrën e përdorimit të Njësive zjarrëfikëse, sistemin e informimit, procedurën në raste shpërthimi të zjarrit, pajisjen teknike, si dhe mjetet tjera për shuarjen e zjarrit.

Neni 10

Vend me rëndësi për mbrojtjen nga zjarri duhet të zërë mënyra e furnizimit me ujë, rrugët, vend-kalimet, bashkëveprimi me Njësitë tjera zjarrëfikëse, si dhe masat tjera që janë të nevojshme për funksionimin e suksesshëm dhe përparimin e mbrojtjes nga zjarri dhe zbatimin e mbikqyrjes lidhur me kryerjen e masave të mbrojtjes nga zjarri.

Neni 11

Përpos masave nga alineja 2 e këtij neni, Rregullorja paraqet edhe masa të veçanta për mbrojtjen e pajisjeve nga zjarri dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Neni 12

Me Planin Urbanistik dhe Hapsinor duhet të parashihen edhe masa tjera mbrojtëse siç janë:

- 12.1 Burimet e furnizimit me ujë, kapaciteti i ujësjellësit të qytetit që duhet të sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit për shuarjen e zjarrit.
- 12.2 Largësinë mes zonave të parapara për objektet e banimit, objektet industriale si dhe objektet për destinim special (depotë e langjëve që ndezen lehtë, gazrave dhe materieve eksplozuese).
- 12.3 Largësinë mes objekteve për destinime të ndryshme. Brenda Zones industriale dhe objekteve speciale që bënë të mundur zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri.
- 12.4 Gjerësinë e rrugëve që bëjnë të mundur afrimin e automjeteve për zjarrëfikje, deri te çdo objekt, dhe manovrimin e tyre gjatë shuarjes së zjarrit.

Neni 13

- 13.1 Organizatat projektuese në territorin e komunës së Malishevës, kanë për detyrë që me rastin e përcaktimit të objekteve ndërtimore, instalimeve, adoptimeve dhe konstruktiveve të aplikohen masat për mbrojtje nga zjarri dhe me dispozitat e nxjerra në bazë të kësaj Rregulloreje.

- 13.2 Projektuesit duhet ti aplikojnë masat për mbrojtje nga zjarri të caktuara sipas kësaj Rregulloreje me rastin e projektimit hapsinor dhe urbanistik

Neni 14

Me rastin e projektimit dhe të ndërtimit të godinave, banesave dhe të objekteve për përdorim publik, si shtëpitë e mallarave, hotelet, kinematë, teatrot, bibliotekat, shkollat, spitalet, hallat sportive, si dhe objektet tjera për përdorim publik, domosdo të sigurohen kushtet për evakuim të sigurt të njerëzve në rast të zjarrit, si dhe aparateve për fikjen e zjarrit.

Neni 15

Objektet në të cilat prodhohen, përpunohen dhe mbahen lëndet djegëse, gassjellësit dhe të gjitha instalimet me aparate në këto objekte, para dhënjes së lejes duhet marrë pëlqimin nga organi kompetent i preventivës së mbrojtjes kundër zjarrit, në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 16

Objektet ndërtimore në të cilat prodhohen, përpunohen dhe mbahen materialet ndezëse, eksplozivi dhe materie të ngjajshme, mund të ndërtohen vetëm në ato vend, e dhe në atë mënyrë që nuk i kanoset rreziku nga zjarri dhe eksplozimi për objektet tjera, e kur të vërtetohet se në to janë zbatuar masat mbrojtëse nga zjarri të parapara me dokumentacion investivo-teknik.

Neni 17

Në objektet dhe lokalet në të cilat prodhohet, përpunohet, shfrytëzohen dhe mbahen lëndët ndezëse, gazrat, eksplozivi dhe materie tjera që ndezen lehtë ose ku krijohet përzierja eksplozive, nuk lejohet:

- 17.1 Pirja e duhanit, përdorimi i zjarrit të hapur dhe mjetet për ndezje.
- 17.2 Shfrytëzimi i stabilimenteve dhe instalimeve që mund të shkaktojnë shpërthimin e zjarrit dhe eksplozimit ndalon:
- 17.3 Të përdoren vegla që nxjerrin xixa.
- 17.4 Shfrytëzimi i aparateve të ngrohjes me zjarr të hapur me sipërfaqe të caktuar.

17.5 Mbrojtja dhe vendosja e materialit që mund të ndezet vetë.

Neni 18

Në objektet prodhuese publike, të banimit dhe në objekte tjera, instalime teknike, të ventilimit, të gazrave, të naftësjellësve, të rrufepritësve, të kanalizimit dhe instalimet tjera, duhet të bëhen në atë mënyrë që të mos praqesin rrezik nga zjarri.

Neni 19

Në ndërtesat e banimit, si dhe ndërtesat në të cilat vendosen ose tubohen numër i madh personash, sigurohen aparatet përkatëse, pajisja me mjete për fikjen e zjarrit dhe ndërmirren masa tjera preventive.

Neni 20

Në ndërtesat e banimit dhe lokale afariste si dhe në objekte tjera, ndërtimore me stabilimentet, instalimet elektrike, të gazrave dhe instalimeve tjera, si dhe rrymëpërcjellësit, duhet të mbahen në gjendje të rregullt ku bartës i përgjrgjësise është pronari i ndërtesës familjare të banimit ose lokalit.

Neni 21

- 21.1 Në objektet në të cilat tubohen numër i madh personash, respektivisht mbahen tubimet publike, organizuesit kanë për detyrë që deri sa këto të zgjasin, të sigurojnë zjarrëfikësit kujdestarë.
- 21.2 Organet e administrates, ndërmarrjet dhe institucionet tjera, dyqanet zejtare, hoteliere dhe tregtare kanë për detyrë të kenë aparate përkatëse për shuarjen e zjarrit fillestar.

Neni 22

Organet e Administrates, ndërmarrjet dhe insitucionet tjera kanë për detyrë t'i njoftojnë punëtorët e inkuadruar për rrezikun nga zjarri, për mënyrën e zbatimit të masave mbrojtëse, si dhe me përdorimin e aparateve të paisjeve dhe të mjeteve për shuarjen e zjarrit.

Neni 23

- 23.1 Me rastin e ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit me hidrante të zjarrit duhet të sigurohen kapaciteti rrjedhës dhe me shtypje për shuarjen e zjarrit.
- 23.2 Në mungesë të hidrantëve dhe mungesë të mjaftueshme të ujit në ujësjellës për shuarjen e zjarrit shfrytëzohen pusat, pishinat, rezervat, si dhe mënyra të tjera vetëm e vetëm për ta shuar zjarrin.

Neni 24

- 24.1 Aparatet, pajisjet teknike dhe mjetet e destinuara për shuarjen e zjarrit, mund të blehen nëse u përgjigjen standardeve.
- 24.2 Aparatet, pajisjet teknike dhe mjetet për shuarjen e zjarrit, të cilat nuk janë paraparë me standardet, apo janë importuar, mund të shfrytëzohen vetëm sipas atestit të siguruar nga institucionet profesionale të autorizuar.

Neni 25

- 25.1 Organet e Administratës, ndërmarrjet dhe institucionet tjera me aktin e vetë normative përcaktojnë masat dhe punët lidhur me zbatimin dhe përparimin e mbrojtjes nga zjarri, në pajtim me këtë Rregullore dhe dispozita tjera:
- 25.2 Masat për mbrojtje nga zjarri
- 25.3 Organizimin, fushëveprimin dhe autorizimet e shërbimit të zjarrëfikjes.
- 25.4 Përgatitjen e punëtorëve që ushtrojnë punët nga zjarri.
- 25.5 Organizimi dhe mënyra e kontrolit të autorizuar dhe përgjegjësve.
- 25.6 Pajisjen teknike përkatëse dhe mjetet për shuarjen e zjarrit.
- 25.7 Detyrat dhe përgjegjësitë e udhëheqësve dhe punëtorëve për masat mbrojtëse nga zjarri.
- 25.8 Përgjegjësinë materiale dhe përgjegjësit tjera për mos kryerje obligimi.
- 25.9 Detyrat e anëtarëve dhe organeve drejtuese me rastin e shpërthimit të zjarrit dhe pjesëmarrja e tyre në shuarjen e zjarrit.

Neni 26

Për zbatimin e masave të parapara me këtë Rregullore për mbrojtje nga zjarri përgjegjës është pronari i ndërtesës respektivisht në ndërmarrje shoqërore-Eprori i ndërmarrjes.

Neni 27

Me punët e caktuara lidhur me përparimin e mbrojtjes nga zjarri mun të merren ndërmarrjet dhe institucionet tjera që i plotësojnë kushtet në pikëpamje të përgatitjes teknike dhe që disponojnë me kuadro profesionale për kryerjen e punëve me shuarjen e zjarrit.

Neni 28

- 28.1 Gjatë kohës së korrijes dhe shirjes ndërmirën masa të posaçme që të lashtat të mbrohen nga zjarri.
- 28.2 Organet Komunale, Administrata lokale, ndërmarrjet dhe organizatat bujqësore formojnë shtabet e përbashkëta në zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri.
- 28.3 Këto shtabe kanë detyrë kontrollin teknik të makinave fshirëse, traktorëve, kombajnave e mjeteve tjera që mos të vijë deri te paraqitja e zjarrit, e në rastet paraqitjes, të bëhet informimi i menjëhershëm për të evituar rrezikun e shkatërrimit të drithnajave me përmasa më të gjëra.

Neni 29

Me qëllim të marrjes pjesë në zbatimin e masave preventive të mbrojtjes nga zjarri, si dhe për shuarjen e zjarrit me shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë së rrezikuar nga zjarri, formohen Njësitë zjarrëfikse nëpër ndërmarrje dhe organizata tjera.

Neni 30

Me aktin mbi formimin e Njësisë zjarrëfikse, përcaktohet fushëveprimi i punës së Njësisë, pajisja teknike si dhe forma e financimit.

Neni 31

Ndërmarrjet që prodhojnë, përpunojnë dhe mbajnë material ndezës, eksploziv, gazra dhe materiale tjera ndezëse, kanë për detyrë që të kenë të formuar Njësinë zjarrëfikse të përhershme dhe të aftësuar.

Neni 32

Njësitë zjarrëfikse kanë për detyrë që reciprokisht të bashkëpunojnë dhe t'i japin ndihmë njëra-tjetrës.

Neni 33

Ndërmarrjet janë të obliguara që të sigurojnë për Njësit e tyre zjarrëfikse uniforma përkatëse, me pajisje të nevojshme dhe profesionale të atestuara.

Neni 34

Qytetarët mund të themelojnë Shoqërinë zjarrëfikse vullnetare në vendet ku jetojnë, të jenë të aftësuar profesionalisht, të jenë të regjistruar në Administratën ndërkombëtare dhe lokale.

Neni 35

- 35.1 Çdo qytetar që vëren shpërthimin e zjarrit ka për detyrë dhe obligim që ta shuajë nëse këtë mund ta bëjë, pa iu kanosur rreziku atij apo të tjerëve.
- 35.2 Nëse nuk është në gjendje ta shuajë zjarrin ka për obligim që të informojë Njësinë zjarrëfikse, policinë apo ndonjë organ tjetër më të afërm.
- 35.3 Punëtoret në mbrojtjen e pyjeve dhe ndërmarrja e cila udhëheq me pyje, përpos obligimit të tyre organizon fikjen e zjarrit me pjesëmarrje të qytetarëve e lokalitetit më të afërt të zjarrit.

Neni 36

- 36.1 Nëse Njësia zjarrëfikse nuk mund të fikë zjarrin, eprori i njësisë do të kërkojë ndihmë nga njësitë tjera zjarrëfikse nga territori i Komunës.
- 36.2 Njësia zjarrëfikse nga e cila është kërkuar ndihma, ka për detyrë të japë ndihmë në pajtimin me këtë Rregullore për mbrojtje nga zjarri.
- 36.3 Nëse edhe me pjesëmarrjen e Njësisë nuk është arritur shuarja e zjarrit, ftohen Njësitë profesionale të zjarrëfiksëve, apo në qoftë se zjarri ka marrë përmasa më të mëdha kërkohet ndihma nga Komunitet tjetër të Kosovës.

Neni 37

Për shuarjen e zjarrit ka pengesë dhe në mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë së rrezikuar nga zjarri, udhëheqësi i aksionit të shuarjes së zjarrit ka të drejtë dhe detyrë:

- 37.1 Të ndalojë afrimin e personave të pa ftuar në vendin e shuarjes së zjarrit, si dhe qarkullimin e komunikacionit afër atij vendi.
- 37.2 Të udhërojë evakuimin e personave dhe pasurisë nga lokalet dhe objektet e rrezikuara.
- 37.3 Të urdhëroi ndërprerjen e energjisë elektrike, të gazit dhe lëndëve djegëse.
- 37.4 Të urdhërojë përdorimin e ujit që shfrytëzojnë qytetarët, Administrata Komunale, ndërmarrjet si dhe institucionet, nëse nuk sigurohet ndonjë burim tjetër për shuarjen e zjarrit.
- 37.5 Të urdhëroi shfrytëzimin e automjeteve të qytetarëve, organeve shtetërore, ndërmarrjeve me qëllim të transportit të të lënduarëve nga zjarri, si dhe sjelljen e mjeteve për shuarjen e zjarrit.
- 37.6 Të urdhërojë rrënimin e pjesërishëm ose të plotë të objektit që nuk është përfshirë nga zjarri, në raste se nuk mund të sigurohet në mënyrë tjetër shuarja e zjarrit ose shpëtimi i njerëzve.
- 37.7 Të marrë masa për sigurimin e pasurisë së evakuar.
- 37.8 Të hapë me force objektin ose lokalitetin e mbyllur me qëllim të shuarjes së zjarrit ose shpëtimit të njerëzve dhe pasurisë.

Neni 38

- 38.1 Në rast të shpërthimit të zjarrit në përmasa më të gjëra, Kryetari i Komunës dhe Komiteti për Gatishmeri Emergjente ose personi i autorizuar nga këta, mund të japë urdhër që të gjithë personat nga territori i Komunës të cilët janë mbi moshën 16 vjeçare të marrin pjesë në shuarjen e zjarrit.
- 38.2 Kryetari i Komunës dhe KGE ose personi i autorizuar nga këta, mund t'i urdhërojë qytetarët, Administratën, ndërmarrjet, njësitë zjarrëfikse si dhe institucionet tjera që merren të nevojshme për shuarjen e zjarrit.
- 38.3 Me aksionin e shuarjes së zjarrit udhëheqësi i Njesisë, e cila e para ka arritur në vendin e ngjarjes, nëse ndryshe nuk merren vesh.

Neni 39

Njësitë zjarrëfikse kanë për detyrë t'ju vijnë në ndihmë edhe Njësitë zjarrëfikse të FSK-së si dhe njësitë tjera të Oraganizatave punuese dhe subjekteve tjera, ndërsa në shuarjen e zjarrit udhëheq eprori i asaj njësie që ka arritur i pari në vendin e ngjarjes, nëse ndryshe nuk merren vesh.

Neni 40

Nëse për shuarjen e zjarrit, shpëtimin e njerëzve dhe të pasurisë së rrezikuar nga zjarri, është e nevojshme ndihma e Njesisë zjarrëfikse të shtetit fqinjë, atë ndihmë e kërkon Kryetari i Komunës dhe Komiteti për Gatishmeri Emergjentë ose personi i autorizuar nga këta

Neni 41

Mbikqyrjen në zbatimin e dispozitave dhe masave për mbrojtjen nga zjarri e bënë Organi i Preventivës dhe Inspektimit në bashkpunim me PK-së.

Neni 42

Organet e Administrates, ndërmarrjet dhe institucionet tjera, si dhe qytetarët kanë për detyrë t'ju mundësojnë Inspektorëve në kryerjen e punës pa pengesa në lëminë e mbrojtjes nga zjarri dhe të japin shënime në lidhje me paraqitjen e zjarrit.

Neni 43

Nëse organet e administrates, ndërmarrjet dhe institucionet tjera dhe qytetarët nuk i kanë zbatuar masat mbrojtëse nga zjarri, organi kompetent i preventives së mbrojtjes nga zjarri, jep urdhër për kryerjen e këtyre masave dhe cakton afatin për kryerjen e tyre.

Neni 44

Organi kompetent i preventives së mbrojtjes nga zjarri përveç masave të caktuara të mbrojtjes nga zjarri, me vendim mund të caktoj ndërmarrjen edhe të këtyre masave:

- 44.1 Zgjerimin, meremetimin dhe adoptimin e objekteve me qëllim të pengimit, shpërthimit dhe përhapjes së zjarrit.

- 44.2 Meremetimin, transformimin ose demontizimin e aparateve dhe instalimeve nga të cilat kanoset rreziku i shpërthimit të zjarrit.
- 44.3 Largimin e pengesave ndërtimore dhe pengesave tjera ose instalimeve që me rastin e shpërthimit të zjarrit pengojnë në shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë.
- 44.4 Ndalimin e përdorimit të objekteve, mjeteve, aparateve të punës, instalimeve dhe gjërave të tjera që konstatohet se me përdorimin e tyre paraqet rrezik për përhapjen e zjarrit.
- 44.5 Ndalimin e përdorimit të aparateve për nxemje me zjarrë të hapët, të sipërfaqeve tepër të nxehta dhe të skuqura me flakë të aparateve për salldim.
- 44.6 Ndalimin e pirjes së dukanit në objekte, lokale dhe hapsirë, në të cilat vendosen ose shfrytëzohen langjet ndezëse, gazrat ndezëse, materialet eksplozive ose krijohen përzierje eksplozive dhe materiale tjera ndezëse.
- 44.7 Blerjen e aparateve të nevojshme zjarrëfikse, pajisjeve me mejte për shuarjen e zjarrit si dhe ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.
- 44.8 Njohjen e punëtorëve me burimin e rreziqeve nga zjarri, me masat mbrojtëse nga zjarri dhe me mënyrën e përdorimit të aparateve dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit.

Neni 45

Për respektimin e kësaj Rregullore në kryerjen dhe mos kryerjen e detyrave, Organi i Preventivës dhe Inspektimit i DMSH, ka për detyrë të përpilojë procesverbalin dhe një kopje të procesverbalit i dorëzohet organit të administrates, ndërmarrjes ose institucioneve tjera në të cilat është kryer kontrolli.

Neni 46

Mjetet për punë dhe pajisjet teknike të Njesisë zjarrëfikse në organet e Administrates, ndërmarrjet dhe institucionet i sigurojnë organet respektivisht organizatat të cilat kanë themeluar Njësinë zjarrëfikse.

Neni 47

Shoqëritë e sigurimit kanë për detyrë që t'i paguajnë fondit të mbrojtjes kundër zjarrit 5% nga të gjitha premitë e sigurimit nga zjarri.

Neni 48

Shuma e inkasuar nga gjobat për kundërvajtje nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri, i takojnë fondit të mbrojtjes kundër zjarrit në territorin e së cilës bëhet kundërvajtja.

Neni 49

Mjetet nga nenet 47 dhe 48 të kësaj Rregulloreje hyjnë në fondin e posaçëm për mbrojtjen nga zjarri dhe shfrytëzohen ekskluzivisht për përparimin e mbrojtjes nga zjarri siç janë:

- 49.1 Për blerjen e pajisjeve dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit.
- 49.2 Për ndërtimin e objekteve për vendosjen e Njësive zjarrëfikse dhe të pajisjeve.
- 49.3 Për shkollimin dhe përfeksionimin profesional të kuadrove të Njesisë zjarrëfikëse.
- 49.4 Për zhvillimin e aktiviteteve edukativo-preventive.

Dispozitat ndëshkimore

Neni 50

Me gjobë prej 1000 € deri 1500 €, do të dënohet për kundërvajtje ndërmarrja dhe përsone juridik

- 50.1 Nëse nuk ka nxjerrë Planin dhe aktet normative përkatëse mbi mbrojtjen nga zjarri
- 50.2 Nëse keqpërdorë mjetet për shuarjen e zjarrit.
- 50.3 Nëse nuk themelon Njësinë zjarrëfikse.
- 50.4 Nëse nuk zbaton masat e parapara ose të urdhëruara për mbrojtje nga zjarri.
- 50.5 Nëse nuk vepron sipas masave të parapara të mbrojtjes ndaj zjarrit në bujqësi dhe pylltari.
- 50.6 Nëse nuk i zbaton masat e urdhëruara të mbrojtjes nga zjarri në afatin e caktuar me aktvendimin e inspektorit të preventivës.

Neni 51

Me gjobë prej 500 € deri 1000 €, do të dënohet për kundërvajtje ndërmarrja dhe përsone juridik:

- 51.1 Nëse shfrytëzon respektivisht vë në veprim objektin, instalimin dhe lokalin e ndërtuar të adoptuar, dhe të konstruktuar para se të sigurojë lejen e organit kompetent sipas nenit 14.
- 51.2 Nëse nuk vepron sipas dispozitave të nenit 18 të kësaj Rregulloreje.
- 51.3 Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 20, 28 dhe 41 të kësaj Rregulloreje.
- 51.4 Në qoftë se është urdhëruar, për shkak të arsyeshem nuk lë në dispozicion veglat, mjetet transportuese, teknike dhe mjetet tjera të nevojshme për shuarjen e zjarrit, dhe shpëtimin e njerëzve dhe të pasurisë së rrezikuar nga zjarri (neni 38).
- 51.5 Nëse parandalon dhe pengon Inspektorin në kryerjen e punëve të inspektimit ose refuzon t'ia japë shënimet dhe informatat e nevojshme "neni 45" për kundërvajtje nga alineja 1 e këtij neni denohet me gjobë deri me 150 Euro edhe përsone përgjegjës në ndërmarrje, respektivisht përsone tjetër juridik.

Neni 52

Me gjobë prej 500 € deri 1000 €, do të dënohen për kundërvajtje ndërmarrja dhe personi tjetër juridik:

- 52.1 Nëse nuk vepron sipas dispozitave të alinesë 1 të nenit 15.
- 52.2 Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 16.
- 52.3 Nëse nuk i merr masat preventive të mbrojtjes nga zjarri dhe nuk e siguron materialin dhe mjetet e nevojshme për shuarjen e zjarrit "neni 20".
- 52.4 Nëse nuk vepron sipas dispozitës së nenit 21 të kësaj Rregulloreje Për kundërvajtje nga alineja 1 të këtij neni do të dënohet me gjobë prej 50 € deri 100 € dhe personi përgjegjës në ndërmarrje, respektivisht personi juridik.

Neni 53

Me gjobë prej 50 € deri 100 €, dënohet personi-individi:

- 53.1 Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 35.
- 53.2 Nëse është urdhëruar në shuarjen e zjarrit, refuzon të marrë pjesë për shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë së rrezikuar "neni 37".
- 53.3 Me gjithë se është i urdhëruar nga organi kompetent, për shkak të arsyeshem refuzon t'i lërë në dispozicion Njesisë zjarrëfikse, veglat, mjetet transportuese dhe mjetet tjera të nevojshme për shuarjen e zjarrit "neni 38".

Neni 54

Me gjobë prej 10 € deri 25 €, do të dënohet personi në vend të për kundërvajtje:

- 54.1 Nëse me kërkesën e personit të autorizuar nuk largohet prej vendit të zjarrit.
- 54.2 Nëse pi duhan ose përdorë zjarrin e hapur në vendin ku ajo është e ndaluar.
- 54.3 Nëse nuk mënjanon materialet ndezëse në lokalet dhe hapsirat e rrezikuara nga zjarri.

Neni 55

Me gjobë prej 25 € deri 50 €, do të dënohet në vend të ngjarjes për kundërvajtje personi përgjegjës i personit juridik dhe zanatliu i pavarur.

- 55.1 Nëse lejon atje ku është e ndaluar pirja e duhanit të përdoret zjarri i hapur, ose vegla e cila shkakëton xixa.
 - 55.2 Nëse nuk kujdeset që të menjahohen materialet ndezëse nga lokalet dhe hapsirat e rrezikuara me zjarr.
 - 55.3 Nëse nuk kujdeset që paisja me aparatet zjarrëfikse të jenë në gjendje të rregullt dhe në vendin e përshtashëm.
 - 55.4 Nëse lejon që rrugët për evakuim dhe dalje në rast rreziku dhe hyrjes për intervenime zjarrëfikse të mbyllen ose të pengohen.
- Për kundërvajtje nga alineja 1 pika 2 e këtij neni e cila është kryer pranë vendit ku janë të vendosura ose ku punohen materialet ndezëse dhe eksplozivi, kryesisht do të denohen me gjobë prej 25 € deri me 250 Euro.

Neni 56

- 56.1 Gjobën në vend për kundërvajtje e inkason personi i autorizuar zyrtar, Inspektori Komunal ose organi tjetër i administrates së autorizuar.
- 56.2 Në qeverisjen e fondit marrin pjesë, Organi i Preventivës i DMSH si organ përgjegjës, përfaqësuesit e administrates, ndërmarrjeve dhe institucioneve me numër të caktuar anëtarësh."neni 49".

Neni 57

Me miratimin e kësajë Rregulloreje bie nga fuqia Rregullorja Nr. 01/807 të dates 26.09.2003.

Neni 58

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.



Kryesuesi i Kuvendit

Ragip Begaj